



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

Himarë , më 13.06.2025

Lënda: Kthim përgjigjeje të kërkesës suaj për informacion në platformën elektronike e-mail datë 02.06.2025.

Në përgjigje të shkresës suaj me objekt “Kërkesë për informacion në lidhje me investimin e nisur në muajin Prill të vitit 2023, për ndërtimin e një ure në fshatin Kallarat, Njësia Administrative Horë-Vranisht, ju bëjmë me dije si më poshtë:

1.Në lidhje me çështjen “A ka pasur një projekt të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak për ndërtimin e kësaj ure? Nëse po, mund të na e vini në dispozicion?”

Nuk ka pasur asnjë “projekt teknik” të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak për ndërtimin e kësaj ure. Konkretisht ka pasur vetëm një fond të miratuar nga Këshilli Bashkiak, i cili për shkak të procedurave administrative dhe afateve përkatëse nuk është arritur të realizohet.

2.Në lidhje me çështjen “A është zhvilluar ndonjë procedurë prokurimi për ndërtimin e urës?”

Nuk është zhvilluar asnjë procedurë prokurimi për këtë qëllim, siç sqarohet më sipër.

3.Në lidhje me çështjen “Cila ka qenë firma e kontraktuar për ndërtimin e urës?”

Nuk ka asnjë firmë të kontraktuar për ndërtimin e urës.

4.Në lidhje me çështjen “Sa ka qenë fondi i realizimit të punimeve dhe të kujt janë këto para (qeverisë, Bashkisë, donacione)?”

Nuk ka fonde të “realizuara” për këtë punim nga asnjë burim (as nga qeveria, Bashkia apo donacione).

5.Në lidhje me çështjen “Përse ura nuk ka përfunduar pas 2 vjetësh nga nisja e punimeve?”
Prokurimi për këtë investim nuk është kryer, siç sqarohet më sipër.

6.Në lidhje me çështjen “Kur do të përfundojë realizimi i urës?”

Punimet e referuara në kërkesën tuaj nuk kanë filluar ende, por Bashkia Himarë mbetet e angazhuar në ndjekjen e të gjithë hapave ligjorë dhe administrative për realizimin e projekteve që i shërbejnë komunitetit.